Tax authorities no longer have any specific right to request opening of procedures. They should follow the same rules as other creditors.

In case the bankruptcy procedure is requested by the creditor, the bankruptcy court shall accept such request if the creditor proves that the debtor is insolvent. Additionally, the creditor will need to prove the existence of an outstanding matured debt.

Notwithstanding the above, the insolvency is assumed if the creditor has failed in executing an obligation in a compulsory enforcement procedure during the period of voluntary enforcement (as provided by Article 517 of the Code of Civil Procedure). The debtor may by evidence rebut such assumption proving that it is solvent and that it does not owe the creditor an outstanding matured debt.

When creditors request the bankruptcy, the court will notify the debtor of the request within 5 days, attaching a full copy of the creditor's submission and supporting documents.

The debtor will have 10 days from the moment it is notified on the request to oppose in writing the commencement of bankruptcy procedures, providing all documents necessary to support his claims. If the debtor does not oppose within the given deadline, the court will declare the commencement of procedures within 3 days.

In case the debtor opposes the commencement of the bankruptcy procedures the bankruptcy court shall within 5 days:

- set the court hearing date, which shall take place no later than 30 days;
- send notice to the debtor to appear at the court hearing, as well as the creditor who requested the opening of the procedures;
- if any of the parties requests the appointment of an expert, or if the bankruptcy court considers it essential to have an expert opinion to decide on the commencement of the bankruptcy process, the court may decide to appoint an expert or temporary administrator to: verify if there is a cause to commence the bankruptcy procedure; verify whether the debtor's assets will cover the costs of the bankruptcy procedure; supervise the debtor's operations; provide an opinion on whether it is necessary to impose provisional measures to secure assets.

LIGJI PËR FALIMENTIMIN

Parë nga Perspektiva e Kreditorit

ARMANDO BODE
Associate

Më datë 27.10.2016 Parlamenti i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 110/2016 "Për falimentimin" (në vijim "Ligji"), i cili është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 226, datë 22.11.2016. Ligji ka hyrë në fuqi më datë 22.05.2017 dhe ka efekt mbi procedurat e nisura pas kësaj date.

Procedura e falimentimit është menduar të përmbushë bashkërisht detyrimet e debitorit nëpërmjet riorganizimit ose likuidimit të aseteve të debitorit ose shpërndarjes së pasurisë.

Ky artikull ka për qëllim të ilustrojë disa nga aspektet e procedurës së falimentimit nga këndvështrimi i kreditorit.

1 Kush është kreditori?

Kreditorët kategorizohen në *kreditorë të procedurës së falimentimit* dhe *kreditorë të falimentimit*.

Kreditori i procedurës së falimentimit është kreditori pretendimi i të cilit rrjedh pas fillimit të procedurës së falimentimit. Ky kreditor paguhet nga masa e falimentimit sipas mënyrës dhe kufizimeve të parashikuara nga Ligji.

Kreditorët e falimentimit përfshijnë *kreditorët e siguruar, kreditorët e preferuar, kreditorët e pasiguruar* dhe *kreditorët fundorë*.

- *Kreditori i falimentimit* – është kreditori pretendimi i të cilit rrjedh përpara fillimit të procedurës së falimentimit.
- *Kreditori i siguruar* – është kreditori cili zotëron të drejta të vlefshme mbi pasuritë e siguruara, me peng, hipotekë ose me çdo formë tjetër sigurimi të njohur nga ligji.
- *Kreditori i preferuar* – është kreditori i cili ka një nga pretendimet e mëposhtme:

- Pretendime të cilat nuk kalojnë shumën 500.000 Lekë që rrjedhin nga ndërprerja e kontratës së punësimit deri në 3 muaj përpara paraqitjes së kerkesës së falimentimit, duke perfshirë pagën, rimbursimin shëndetësor dhe pagesat e lejes së lindjes;
- Pretendime për mbështetje dhe mirëmbajtje që lindin përpara fillimit të procedurës së falimentimit kur debitori është një individ;
- Pretendime të punonjësve të debitorit për dëme shëndeti të shkaktuara gjatë punës ;
- Pretendime për veprime të padrejta që rrjedhin si pasojë e dëmit të shkaktuar nga debitori përpara fillimit të procedurës së falimentimit;
- Pretendime për taksat e papaguara një vit përpara paraqitjes së kërkesës për fillimin e procedurës së falimentimit.

- *Kreditori i pasiguruar* - është kreditori që ka pretendime falimentimi të cilat nuk klasifikohen si të siguruara, të preferuara ose fundore.
- *Kreditori fundor* – është kreditori që ka një nga pretendimet e mëposhtme:

- Sanksionet për pagesa të vonuara të llogaritura mbi pretendimet e kreditorëve të falimentimit para fillimit të procedurës së falimentimit;
- Sanksionet sipas Kodit Civil, legjislacionit administrativ dhe Kodit Penal, të cilat janë të detyrueshme për debitorin;
- Shlyerjen e kredive nga personat e lidhur me debitorin, nëse huadhënësi ose ofruesi i kredisë ishte një person i lidhur me debitorin në momentin e veprimit;
- Kredi për të cilat kreditori dhe debitori kanë rënë dakord të klasifikohen si fundore.

2 Kur fillon procedura e falimentimit?

Hapja e procedurës së falimentimit mund të kërkohet nga debitori ose kreditorët e tij në formë të shkruar dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligj.

Autoritetet tatimore nuk kanë më të drejtë specifike të kerkojnë hapjen e procedurave të falimentimit. Tashmë ata i nënshtrohen të njejtave rregulla si kreditorët e tjerë.

Në rast se procedura e falimentimit është kërkuar nga kreditori, gjykata do ta pranojë këtë kërkesë nëse kreditori provon se debitori është në gjendjen e paaftesisë paguese. Kreditori duhet të provojë gjithashtu ekzistencën e një detyrimi të maturuar dhe të papaguar.

Pavarësisht sa më lart, gjendja e paaftësisë paguese prezumohet në qofte se kreditori ka dështuar në ekzekutimin e një detyrimi në një procedure të ekzekutimit të detyrueshëm gjatë periudhës së ekzekutimit vullnetar (sipas parashikimeve të nenit 517 të Kodit të Procedurës Civile). Debitori, nëpërmjet provave, mund të kundërshtojë këtë prezumim duke vërtetuar se ka aftësi paguese dhe se nuk ka një detyrim të maturuar dhe të papaguar ndaj kreditorit.

Kur kreditori paraqet kërkesën për hapjen e procedurës, gjykata njofton debitorin për kërkesën brenda 5 ditëve, duke i bashkëngjitur një kopje të plotë të saj dhe të dokumentave shoqëruese. Debitori ka në dispozicion 10 ditë kohë për të kundërshtuar me shkrim fillimin e procedurave të falimentimit, duke siguruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të mbështetur pretendimet e tij. Nëse debitori nuk e kundërshton brenda afatit të përcaktuar, gjykata do të shpallë fillimin e procedurave të falimentimit brenda 3 ditëve.

Në rast se debitori kundërshton fillimin e procedurave të falimentimit, brenda 5 ditëve gjykata e falimentimit:Vendos daten e seances gjyqesore, e cila do te mbahet jo me vone se 30 dite;

- Vendos datën e seancës gjyqesore, e cila do të mbahet jo më vonë se 30 ditë;
- Thërret në seancë gjyqësore debitorin dhe kreditorin që ka kërkuar hapjen e procedurave të falimentimit;
- Nëse një nga palët kërkon caktimin e një eksperti ose nëse gjykata e falimentimit konsideron të domosdoshme që të ketë një opinion të ekspertit për të vendosur mbi fillimin e procedurave të falimentimit, gjykata mund të vendosë të caktojë një ekspert ose administrator të përkohshëm për të verifikuar nëse pasuritë e debitorit mund të mbulojnë kostot e

As a general principle, the commencement of bankruptcy procedures does not impact the continuance of the contracts that have not been fully executed by the debtor or the counterparty, unless otherwise provided by the Law.

3 What happens in the period between the filing for bankruptcy and decision of the court?

Creditors may be concerned that during this period the debtor undertakes actions that may harm their interests. Therefore they may ask the bankruptcy court to issue injunction orders. The court may also ex officio issue such orders. Especially the court may appoint a temporary administrator supervising or substituting the debtor in the management of the activity, decide to prohibit the debtor to dispose of the property in any manner that exceeds the normal activity of the debtor, order other measures that are deemed necessary for avoiding harms to the financial and economical situation of the debtor to the detriment of the creditors.

The injunction orders shall be valid for a period of 30 days up to a maximum of an additional 30 days period. Upon expiry of the maximum deadline, these orders are no longer valid.

4 Can experts be appointed?

In case the bankruptcy administrator does not have the required skills to observe or clarify certain facts, the court may appoint experts, upon request of the parties or ex officio, at any time during the procedure.

5 How are organized the creditors in an insolvency proceedings?

5.1. TEMPORARY CREDITORS' COMMITTEE

When the court finds that the request for the commencement of the bankruptcy procedures is in compliance with the provisions of the Law, issues its decision which inter alia shall provide for the appointment of a temporary creditors' committee. The court will appoint 3 members, including the 2 largest unsecured creditors and the largest preferred creditor. If one of the categories is not available or if the creditors refuse to join the creditors' committee, the court will choose the following largest amount in any of the categories, except subordinated creditors.

5.2. PERMANENT CREDITORS' COMMITTEE

After the appointment of the temporary creditors' committee, the creditors' meeting can replace or appoint a new creditors' committee at any time. The creditors' committee shall be composed of a minimum of 3 (three) and a maximum of 5 (five) members with voting rights. Each member has one vote, irrespective of the amount of its claim.

The creditors' committee shall be the representative of the bankruptcy creditors, excluding subordinated creditors. Secured creditors may be appointed in the committee, so long as they do not form a majority of votes in the committee. If the debtor has at least 20 employees, at least one employee representative will be entitled to participate in the creditors' committee. The representative of the employees shall have no right to vote on matters being considered by the creditors' committee, unless the employee is a creditor of the debtor and there are other creditors of the same kind.

5.3 CREDITORS' MEETING

The creditors' meeting shall be convened by the bankruptcy court or by the bankruptcy administrator. The administrator may convene whenever it deems necessary for the good functioning of the bankruptcy procedure. The creditors' meeting shall be chaired by the bankruptcy administrator and will be duly constituted with the presence of at least 50% of the total claims in the first call, and 35% in the second.

A. Voting rights

The voting right is determined on the basis of the list of creditors. In all meetings held before the formation of the list of creditors, voting rights will correspond to the claims filed by bankruptcy creditors that are not disputed by the bankruptcy administrator or by any creditor with a voting right. Subordinated creditors shall have no voting rights. Creditors with disputed claims shall have a voting right only to the extent the bankruptcy court decides so, after hearing the administrator and any other person the court deems reasonable.

B. Decisions of the creditors' meeting

A decision of the creditors' meeting shall be valid if a majority in value of the claims of bankruptcy creditors with voting rights and present in person or by proxy vote in favor of such decision.

C. Opposing the decision

The bankruptcy administrator and bankruptcy creditors, except for subordinated creditors, have the right to challenge a decision of the creditors' meeting within five days from the public notice of the decision. The decision can be challenged before the bankruptcy court only due to a breach of the formalities included in the Law for the convening of the assembly, as well as in case of a breach of the rules concerning the adoption of the decision.

D. Right to be informed

The creditors' meeting may require the bankruptcy administrator to provide specific information and report on the progress of the bankruptcy procedure and on the management of the bankruptcy estate.

6 How are the claims deteminded?

6.1 SUBMISSION OF CLAIMS

Everyone who claims to be a bankruptcy creditor must submit in writing its claims (and the supporting documents) to the bankruptcy administrator within the period established in the court decision on commencement of the bankruptcy procedures. Such filing will be accompanied by copies of any documents evidencing the claim.

The claims may also be submitted via electronic means, provided that the consent or authorization of the administrator has been obtained. However, the administrator has the right to request the original documents. With the consent or authorization of the bankruptcy or monitoring administrator, claims may be filed by electronic means. In such a case, the originals of the documents evidencing the claim shall be subsequently filed upon request of the administrator.

For the sole purpose of proving their claims, creditors' claims for obligations that have not yet matured due to the bankruptcy procedure shall be deemed mature.

The submission shall contain the **source of the claim**, **the claimed amount and whether the creditor is secured or preferred.**

Claims from bankruptcy creditors that were included in the list by the administrator and were not objected by the debtor or any other creditor shall be recognized and considered verified by the bankruptcy court.

6.2 OPPOSING TO THE CLAIMS

The claims included in the list of creditors may be challenged by the debtor or bankruptcy creditors within 10 days from the publication of the deposit of the list.

6.3 DELAYED SUBMISSION OF CLAIMS

Claims submitted after the period provided in the court decision on the commencement of the bankruptcy procedures will be considered delayed. Late evidence of claims will in any

procedurave të falimentimit, të mbikeqyrë veprimtarinë e debitorit dhe për të dhënë një opinion nëse është e nevojshme të vendosen masa të përkohshme për të siguruar pasuritë.

Si rregull i përgjithshëm, fillimi i procedurave të falimentimit nuk ndikon vazhdimësinë e kontratave të cilat nuk janë zbatuar plotësisht nga debitori apo pala tjetër, përveç se kur parashikohet ndryshe në Ligj.

3 Çfarë ndodh gjatë periudhës midis paraqitjes së kërkesës për hapjen e procedurave të falimentimit dhe dhënies së vendimit nga gjykata?

Kreditorët të cilët shqetësohen se gjatë kesaj kohe debitori mund të kryeje veprime te cilat dëmtojne interesat e tyre, kanë të drejtë t'i kërkojnë gjykatës së falimentimit vendosjen e masave te përkohshme. Gjykata mund gjithashtu t'i vendosë këto masa kryesisht. Keshtu gjykata mund të caktojë një administrator të përkohshëm për të mbikëqyrur ose për të zëvendësuar debitorin gjatë administrimit të aktivitetit, mund të vendosë ndalimin e debitorit për të disponuar pasurinë në çdo mënyrë që është jashtë veprimtarisë normale të aktivitetit, ose mund të urdhërojë masa të tjera të cilat konsiderohen të nevojshme për të shmangur dëmtimin e situatës financiare dhe ekonomike të debitorit në dëm të kreditorëve.

Masat e përkohshme janë të vlefshme për një periudhë prej 30 ditësh që mund të zgjatet me një periudhe shtesë prej 30 ditësh. Pas kalimit të afatit shtesë, masat e përkohshme humbasin efektet.

4 A mund të caktohen ekspertë?

Nëse administratori nuk zotëron aftesitë e kërkuara për të vërejtur ose shpjeguar fakte të caktuara, gjykata mund të caktojë ekspertë me kërkesën e palëve ose kryesisht, në çdo kohë gjatë procedurës së falimentimit.

5 Si janë të organizuar kreditorë t?

5.1. KOMITETI I PËRKOHSHËM I KREDITORËVE

Pasi gjykata vëren se kërkesa për fillimin e procedurës së falimentimit është në përputhje me parashikimet e Ligjit, nxjerr vendimin e saj në të cilin, ndër të tjera, cakton komitetin e përkohshëm të kreditorëve. Gjykata cakton 3 anëtare, përfshirë 2 kreditorët më të mëdhenj të pasiguruar dhe kreditorin më të madh të preferuar. Nëse njëra prej kategorive nuk është e disponueshme ose kreditorët refuzojnë të bëhen pjesë e komitetit të kreditorëve, gjykata cakton shumën vijuese më të madhe për secilën kategori, përveç asaj të kreditorëve fundorë.

5.2. KOMITETI I KREDITORËVE

Pas caktimit të komitetit të përkohshëm të kreditorëve, mbledhja e kreditorëve, në çdo moment, mund të zëvendësojë ose të caktojë një komitet të ri kreditorësh. Komiteti i kreditorëve do të përbëhet prej të paktën 3 (tre) anëtare dhe deri në maksimumi 5 (pesë) anëtare me të drejtë vote. Secili prej anëtarëve, pavarësisht nga shuma e pretenduar, ka një votë.

Komiteti i kreditorëve do të jetë përfaqësues i kreditorëve të falimentimit, duke përjashtuar kreditorët fundorë.

Kreditorët e siguruar mund të caktohen në komitet, për aq kohë sa ata nuk formojnë shumicën e votave në komitet. Nëse debitori ka të paktën 20 të punësuar, të paktën një përfaqësues nga punëmarrësit do të ketë të drejtën për të marrë pjesë në komitetin e kreditorëve. Përfaqësuesi i punëmarrësve nuk ka të drejtë vote për çeshtjet që trajtohen nga komiteti i kreditorëve, përveç rastit kur punëmarrësi është kreditor i debitorit dhe ka kreditorë të tjerë si ai.

5.3 MBLEDHJA E KREDITORËVE

Mbledhja e kreditorëve thirret nga gjykata e falimentimit ose nga administratori i falimentimit. Administratori mund të thërrasë mbledhjen e kreditorëve sa herë që e gjykon të nevojshme për mirëfunksionimin e procedurës së falimentimit. Mbledhja e kreditorëve kryesohet nga administratori i falimentimit dhe punimet e saj legjitimohen me praninë e 50% të totalit të pretendimeve në thirrjen e parë dhe 35% në të dytën.

A. Të drejtat e votës

E drejta e votës përcaktohet në bazë të listës së kreditorëve. Në të gjitha mbledhjet e mbajtura para formimit të listës së kreditorëve, e drejta e votës korrespondon me kërkesat e parashtruara nga kreditoret e falimentimit që nuk janë të diskutueshme nga administratori i falimentimit ose nga ndonjë kreditor me të drejtë vote. Kreditorët fundorë nuk kanë të drejtë vote. Kreditorët me pretendime të diskutueshme kanë të drejtë vote vetëm në masën e vendosur nga gjykata e falimentimit, pas dëgjimit të administratorit dhe çdo personi tjetër që gjykata e mendon të arsyeshme.

B. Vendimet e mbledhjes së kreditorëve

Vendimet e mbledhjes së kreditorëve do të jenë të vlefshme nëse shumica në vlerën e pretendimeve të kreditorëve të falimentimit me të drejtë vote, të pranishëm personalisht ose përmes përfaqësimit, votojnë në favor të vendimit.

C. Kundërshtimi i vendimit

Administratori i falimentimit dhe kreditorët e falimentimit, me përjashtim të kreditorëve fundorë, kanë të drejtë për të kundërshtuar një vendim të mbledhjes së kreditorëve brenda pesë ditëve nga bërja publike e vendimit. Vendimi mund të kundërshtohet në gjykatën e falimentimit vetëm për shkak të shkeljes së formaliteteve të përfshira në Ligj për thirrjen dhe finalizimin e mbledhjes si dhe në rast të shkeljes së rregullave në lidhje me miratimin e vendimit.

D. E drejta për t'u informuar

Mbledhja e kreditorëve mund t'i kërkojë administratorit të falimentimit të sigurojë informacion specifik dhe të raportojë mbi ecurinë e procedurës së falimentimit dhe mbi administrimin e masës së falimentimit.

6 Si përcaktohen pretendimet?

6.1 PARAQITJA E PRETENDIMEVE

Kushdo që pretendon të jetë kreditor në një procedure falimentimi paraqet me shkrim pretendimet e tij (dhe dokumentat shoqëruese) tek administratori i falimentimit brenda afatit të përcaktuar në vendimin për fillimin e procedurës së falimentimit. Kjo paraqitje shoqërohet me kopje të të gjitha dokumenteve që vërtetojnë pretendimin.

Me pëlqimin ose autorizimin e administratorit të falimentimit ose administratorit mbikëqyrës, pretendimet mund të paraqiten në mënyrë elektronike. Në këtë rast origjinalet e dokumenteve të cilat vërtetojnë pretendimin do të paraqiten me kërkesë të administratorit.

Për qëllim të vërtetimit të pretendimeve të tyre, pretendimet e kreditorëve për detyrimet që nuk janë maturuar ende për shkak të procedurës së falimentimit do të konsiderohen të maturuara. Paraqitja e pretendimit përmban burimin e tij, shumën e pretenduar dhe nëse kreditori është i siguruar ose i preferuar.

Pretendimet e kreditorëve të falimentimit të cilat përfshihen në listën e administratorit dhe nuk janë kundërshtuar nga debitori apo nga ndonjë kreditor, do të njihen dhe konsiderohen si të verifikuara nga gjykata falimentimit.

6.2 KUNDËRSHTIMI I PRETENDIMEVE

case not be considered, if takes place after one year from the commencement of bankruptcy procedures. Delayed claims will loose the right to participate in any decision-making process or to obtain any distribution that took place in the procedures before the claim was filed.

Claims whose existence in the period of filing was made dependent on an investigation that was being conducted by the public administration will also be regarded as delayed claims unless the relevant public administration files a claim as contingent. If there are any extra costs due to the delayed claim, the delayed creditor shall be responsible for them.

7 Reorganization or Liquidation?

7.1. REPORTING MEETING

The reporting meeting of the creditors shall be presided by the bankruptcy court and its main objective to decide whether the bankruptcy procedure will continue by reorganization or liquidation. The meeting will take its decision in accordance with Article 108 of the Law which stipulates that as a general rule, accepting the plan by the creditors requires that in each class of creditors, a majority in value of claims (present or represented by means of a power of attorney) vote in favor of such plan.

Shall the plan provide the reduction of more than 50% of claims or their re-planning for more than 5 years; the affected class must approve such plan with the favorable vote of at least 65% of the claims. If the plan provides that one group of creditors within the same class will be treated differently, those considered as privileged will have to accept upon majority through a separate vote.

The bankruptcy administrator shall report on the financial situation of the debtor and the factors that caused the insolvency. The administrator shall submit the report in writing with the bankruptcy court at least 10 days before the report meeting, and the report shall be available for all parties.

7.2. REORGANIZATION DECISION

Shall the reporting meeting decide to proceed with the reorganization, the administrator will be required to draw up a reorganization plan that must be filed with the bankruptcy court and made public no later than one month before the date of the meeting concerning the deliberation and voting of the plan. The date of the meeting is set by the bankruptcy court and shall take place within 60 days from the report meeting.

7.3 ACCELERATED REORGANIZATION

The accelerated reorganization is another option which provides the debtor with the possibility to overcome a situation of imminent insolvency by reaching an agreement between the debtor and its creditors stipulated out of the bankruptcy court (which is however, subject to the court's approval) through a faster procedure.

A debtor is deemed to be in a situation of imminent insolvency when it is objectively foreseeable that will not be able to satisfy its debts as they fall due in a period of 6 months or less. If the debtor considers itself in a situation of imminent insolvency may request the commencement of accelerated reorganization procedure in accordance with the provisions of the Law.

7.4. LIQUIDATION DECISION

Shall the reporting meeting decide to proceed with the liquidation; the bankruptcy court shall request the bankruptcy administrator to draw up a plan for the liquidation of the debtor's assets in accordance with the Law. To the extent possible, the liquidation plan will include the sale of the business or one or more business units by preserving their continuance.

8 How are secured creditors satisfied?

The bankruptcy administrator or the debtor with the authorization of the monitoring administrator has the right to dispose of any property which is subject to a secured right, if the value of the collateral is larger than the amount owed to the secured creditor including the expenses incurred for the enforcement.

If the value of the collateral is lower than or equal to the aggregate of the value of the amount claimed by the secured creditor and the costs incurred for the enforcement, the bankruptcy administrator or the monitoring administrator, as the case may be, shall decide whether to allow the secured creditor to exercise the right to segregate the object according to the Law.

Before the bankruptcy administrator sells an asset in his/her possession to a third party, he/she shall notify the secured creditor of the proposed sale, who is entitled to have at least 1 week to propose a more favorable alternative of selling the asset.

Subject to the above, following the 6 month suspension period provided by the Law, the secured creditor may begin or continue the execution of the security. However, if the collateral is not necessary for the continuance of the business or professional activity of the debtor, the secured creditor may request the enforcement of the security. If the administrator does not start the enforcement within 15 days from the request, the bankruptcy court may dismiss the administrator or impose a sanction on him/her.

If, following the suspension period, the secured creditor begins or continues the enforcement of the security, the bankruptcy or monitoring administrator may request that the asset, subject to the security right, is held with the aim of selling it later or it is preserved for the continuance of the business activity. In such case, the administrator will pay the secured creditor the amount of the asset calculated in the inventory minus the foreseeable enforcement costs.

When an asset subject to a security right has been sold due to said security right, the proceeds of sale minus the costs incurred in selling the asset shall be used without delay to satisfy the secured creditor. If the bankruptcy administrator transfers to the secured creditor an asset which the administrator has the right to sell with the intent that the asset will be sold by the secured creditor, the secured creditor shall prepay to the bankruptcy administrator the estimated costs of sale as well as the taxes, if any, to be paid from the proceeds of sale of the asset.

9 How is the rank of claims determined?

In case of a liquidation, the administrator shall satisfy the claims of the creditors in the following order:

- secured claims up to the value of the asset serving as collateral;
- claims of preferential creditors;
- claims of unsecured creditors;
- claims of subordinated creditors;
- claims of the partners of partnerships and shareholders of commercial companies.

The payment of creditors of the bankruptcy procedure will take place after their maturity. Payment of bankruptcy creditors will be made taking into consideration the need to pay first the creditors of bankruptcy procedures. In case of doubt, the bankruptcy administrator will set aside an amount before commencing the payment of the creditors included in the previous section of this article.

Pretendimet e përfshira në listën e kreditorëve mund të kundërshtohen nga debitori ose kreditorët e falimentimit brenda 10 ditëve nga publikimi i listës.

6.3 PARAQITJA ME VONESË E PRETENDIMEVE

Pretendimet e paraqitura pas periudhës së caktuar në vendimin e gjykatës në fillim te procedurave të falimentimit do të konsiderohen në vonesë. Vonesa në vërtetimin e pretendimit nuk do të konsiderohet në asnje rast, pasi të ketë kaluar 1 vit nga fillimi i procedurës së falimentimit. Pretendimet e vonuara do të humbasin të drejtën për t'u shqyrtuar në çdo vendim ose të perfitojnë çdo shpërndarje që ka ndodhur në procedurën e falimentimit para se pretendimi të ishte ngritur.

Pretendimet, ekzistenca e të cilave në periudhën e paraqitjes varej nga një hetim i kryer nga administrata publike përkatëse, gjithashtu do të konsiderohen si kërkesa të vonuara me përjashtim të rastit kur administrata publike përkatëse paraqet një pretendim si të kushtëzuar. Nëse ka ndonjë kosto shtesë për shkak të pretendimit të vonuar, kreditori i vonuar do të jetë përgjegjës.

7 Riorganizim apo Likuidim?

7.1.MBLEDHJA E RAPORTIMIT

Mbledhja e raportimit të kreditorëve kryesohet nga gjykata e falimentimit dhe ka si objektiv kryesor të vendosë nëse procedura e falimentimit do të vazhdojë me riorganizim ose me likuidim. Mbledhja do të marrë një vendim sipas shumicës së përcaktuar nga neni 108 i Ligjit i cili parashikon se si rregull i përgjithshëm pranimi i planit nga kreditorët kërkon që në çdo klasë, një shumicë e vlerës së pretendimeve të kreditoreve (të pranishëm ose të përfaqësuar me prokurë) të votojë ne favor të planit.

Nëse plani parashikon reduktimin e më shumë se 50% të pretendimeve ose një riplanifikim të tyre për më shumë se 5 vjet, klasa e prekur do të duhet të miratojë me të paktën 65% te pretendimeve. Nëse plani parashikon se një grup i kreditorëve brenda të njejtës klasë do të trajtohet ndryshe, ata që konsiderohen të privilegjuar nga trajtimi i veçantë, duhet të pranojnë një votim të veçantë nga shumica.

Administratori do te dorëzojë raportin me shkrim në gjykatën e falimentimit të paktën 10 ditë para mbledhjes së raportimit dhe raporti do të jetë në dispozicion për të gjitha palët pjesëmarrëse.

7.2. VENDIMI PËR RIORGANIZIM

Nëse mbledhja e raportimit vendos riorganizimin, administratorit i kërkohet të hartojë një plan riorganizimi i cili duhet të depozitohet në gjykatën e falimentimit dhe të bëhet publik jo më vonë se një muaj përpara datës së mbledhjes së diskutimit dhe votimit të planit. Data e mbledhjes përcaktohet nga gjykata e falimentimit dhe kjo mbledhje mbahet jo më vonë se 60 ditë pas mbledhjes së raportimit.

7.3 RIORGANIZIMI I PËRSHPEJTUAR

Riorganizimi i përshpejtuar është një alternativë tjetër që ka për qellim t'i japë debitorit mundesinë për të kapërcyer një situatë të pashmangshme të paaftesisë paguese me anë të një marrëveshje ndërmjet debitorit dhe kreditorëve, të hartuar jashtë gjykatës së falimentimit (e cila gjithsesi duhet të miratohet nga gjykata) nëpërmjet një procedure më të shpejtë.

Debitori konsiderohet në një situatë të pashmangshme paaftësie paguese, kur është objektivisht e parashikueshme që nuk do të jetë në gjendje për të shlyer në kohë detyrimet në një periudhë prej 6 muajsh ose më pak. Nëse debitori e konsideron veten në një situatë të pashmangshme paaftësie paguese mund të kërkoje fillimin e procedurës së përshpejtuar të riorganizimit sipas parashikimeve të ketij Ligji.

7.4. VENDIMI I LIKUIDIMIT

Nëse mbledhja e raportimit vendos të fillojë likuidimin, gjykata e falimentimit do t'i kërkojë administratorit të hartojë një plan për likuidimin e masës së falimentimit në përputhje me Ligjin. Për aq sa është e mundur, plani i riorganizimit do të përfshijë shitjen e aktivitetit ose të një ose më shumë aktiviteteve duke ruajtur vazhdimësinë e tyre.

8 Si kryhet shlyerja e kreditorëve të siguruar ?

Administratori i falimentimit ose debitori me autorizimin e administratorit mbikëqyres, ka të drejtë të disponojë çdo pasuri që është objekt i një të drejte të siguruar, në qoftë se vlera e kolateralit është më e madhe se shuma që i detyrohet kreditorit të siguruar së bashku me shpenzimet e bëra për ekzekutimin e tij.

Nëse vlera e kolateralit është më e vogël ose e barabartë me totalin e vlerës së kredisë së pretenduar nga kreditori i siguruar dhe shpenzimet e bëra për ekzekutimin e saj, administratori i falimentimit ose administratori mbikëqyrës, në varësi të rastit, vendos nëse do të lejojë që kreditori i siguruar të ushtrojë të drejtën për ta ndarë objektin në përputhje me këtë Ligj.

Përpara se administratori i falimentimit të shesë një pasuri në posedim të tij tek një palë e tretë, ai njofton kreditorin e siguruar për shitjen e propozuar. Kreditorit të siguruar i jepet të paktën 1 javë kohë për të propozuar një alternativë tjetër më të favorshme për shitjen e pasurisë.

Në përputhje me sa më sipër, pas periudhës 6 mujore të pushimit te parashikuar nga Ligji, kreditori i siguruar mund të fillojë ose vazhdojë ekzekutimin e kolateralit. Megjithatë, nëse kolaterali nuk është i nevojshem për vazhdimësinë e veprimtarisë tregtare ose aktivitetit profesional të debitorit, kreditori i siguruar mund të kërkojë që te ekzekutohet garancia. Nëse administratori nuk fillon ekzekutimin brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës, gjykata e falimentimit mund të shkarkojë administratorin ose të vendosë nje sanksion ndaj tij.

Nëse pas periudhës së pushimit të përmendur më lart, kreditori i siguruar fillon ose vazhdon ekzekutimin e kolateralit, administratori i falimentimit ose administratori mbikëqyrës mund të kërkojë që pasuria, e cila është objekt i te drejtës së siguruar, të mund të mbahet me qëllim shitjen e saj në një kohë të mevonshme ose të mbahet me qëllim ruajtjen e vazhdimësisë së veprimtarisë tregtare. Në këtë rast administratori do t'i paguajë kreditorit të siguruar vlerën e pasurisë së llogaritur në inventar, minus kostot e parashikuara të ekzekutimit.

Kur një pasuri, objekt i një te drejtë te siguruar është shitur për shkak të kësaj të drejte, të ardhurat nga shitja minus kostot e shkaktuara prej shitjes së pasurisë përdoren pa vonesë për të shlyer kreditorin e siguruar. Nëse administratori i falimentimit i transferon kreditorit të siguruar një pasuri të cilën administratori ka të drejtë ta shesë me qëllim që pasuria të shitet nga kreditori i siguruar, ky i fundit do t'i parapaguajë administratorit të falimentimit kostot e vlerësuara të shitjes, dhe nëse është rasti detyrimet fiskale do të paguhen nga të ardhurat e shitjes së pasurisë.

9 Si përcaktohet renditja e pretendimeve?

Në rastin e likuidimit, administratori do të shlyejë pretendimet e kreditorëve sipas rradhës së mëposhtme:

- Pretendimet e siguruara deri në vlerën e pronës që shërben si kolateral;
- Pretendimet e kreditorëve të preferuar;
- Pretendimet e kreditorëve të pasiguruar;

10 Can transactions stipulated before the commencement of the procedure be challenged?

As a general rule, all actions of the debtor executed in a period of two (2) years before the commencement of bankruptcy procedures can be challenged if they caused a patrimonial damage to the debtor or have granted an unjustified preference to a creditor.

The bankruptcy or monitoring administrator will be primarily competent to start challenging actions in bankruptcy procedures.

Creditors, who identify an act of the debtor that may be challengeable, can communicate it to the bankruptcy or supervisory administrator. If the administrator does not start the challenging action within a period of two (2) months from the communication, that creditor has the right to file the action at his own expense and risk. If the creditor files the claims, the administrator must be notified.

Challenging actions may be initiated only within the first 3 (three) years following the commencement of the bankruptcy procedure, unless it was objectively unforeseeable earlier that a given transaction could be subject to challenge. The action must be started against the debtor and the other parties in the challenged act or transaction. If the asset, object of the transaction has been transferred to a third party, the action must also be addressed against the third party so long as the plaintiff challenges the right of the third party to keep possession or property of the asset.

The bankruptcy court shall be competent to decide on the claims regarding the challenging case pursuant to the general procedural rules.

11 When is the bankruptcy procedure closed?

After the completion of the final distribution, the bankruptcy court orders the closing of the bankruptcy procedure. Full payment to all bankruptcy creditors at any stage of the procedure is also a cause for closing the procedure. Such order and the reasons for closing shall be publicly announced.

In case of legal entities, and unless all creditors have been fully satisfied, the full distribution of proceeds following the liquidation of assets will entail the dissolution of the legal entity. The bankruptcy administrator shall file the order of the bankruptcy court with the relevant register in order to remove the debtor from the said registry.

- Pretendimet e kreditorëve fundorë;
- Pretendimet e partnerëve dhe aksionarëve të shoqërive tregtare.

Pagesa e e kreditorëve të procedurës së falimentimit zhvillohet pasi pretendimet të jenë maturuar. Pagesa e kreditorëve të falimentimit bëhet duke marrë parasysh nevojën për të paguar në rradhe të parë kreditorët e procedurës së falimentimit. Në rast dyshimi, administratori i falimentimit ndan një shumë monetare përpara se të fillojë pagesën e kreditorëve të përmendur në seksionin më sipër.

10 A mund të kundërshtohen veprimet e kryera përpara fillimit të procedurës së falimentimit ?

Si rregull i përgjithshem, të gjitha veprimet e debitorit të ekzekutuara gjatë një periudhe 2 (dy) vjeçare përpara fillimit të procedurave mund të kundërshtohen në rast se debitorit i kanë shkaktuar dëm pasuror ose i kanë dhënë preferencë të pajustifikuar një kreditori.

Administratori i falimentimit ose administratori mbikëqyrës ka përgjegjësine për të filluar kryesisht veprimet e kundërshtimit në procedurën e falimentimit.

Kreditorët të cilët identifikojnë një veprim të kundërshtueshëm të debitorit, mund t'ia komunikojnë këtë administratorit të falimentimit ose administratorit mbikëqyrës. Në qoftë se administratori nuk fillon kundërshtimin e veprimeve brenda një periudhe prej 2 (dy) muajsh nga data e komunikimit, kreditori njoftues ka të drejtë të kundërshtojë veprimin duke marrë përsiper shpenzimet dhe pasojat.

Nëse kreditori paraqet kundërshtimin, duhet të njoftohet administratori.

Kërkesa për kundershtim mund të paraqitet vetëm brenda 3 (tre) viteve nga fillimi i procedurës së falimentimit, përveç rasteve kur ka qenë objektivisht e pamundur për të marrë dijeni për shkakun e kundërshtimit të veprimit. Kundërshtimi paraqitet kundër debitorit dhe palëve të tjera pjesëmarrëse në veprimin objekt kundërshtimi.

Nëse pasuria, objekt kundërshtimi, është transferuar te një palë e tretë kundërshtimi duhet gjithashtu t'i drejtohet palës së tretë nëse kundërshtohet e drejta e kësaj pale mbi këte pasuri.

Gjykata e falimentimit është kompetente për të gjykuar paditë për kundershtimin duke zbatuar rregullat e përgjithshme.

11 Kur përfundon procedura e falimentimit?

Pasi ka përfunduar shpërndarja përfundimtare, gjykata e falimentimit urdhëron përfundimin e procedurës së falimentimit. Pagesa e plotë për të gjithë kreditorët e falimentimit në çdo fazë të procedurës është gjithashtu një shkak për përfundimin e procedurës. Urdhri dhe arsyet e përfundimit shpallen publikisht.

Në rastin e personave juridikë, dhe derisa të gjithë kreditorët të shlyhen plotësisht, shpërndarja e plotë e të ardhurave, pas likuidimit të pasurisë sjell prishjen e personit juridik. Administratori i falimentimit dërgon urdhrin e gjykatës së falimentimit në regjistrat përkatës në mënyrë që të fshijë debitorin nga këto regjistra.

abi

AMERICAN BANK
OF INVESTMENTS

investo në optimizëm

www.abi.al